



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Datë: 15.07.2020**

**Gjakovë**  
Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Direjtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/02-1576A  
Data/Datum 23.07.2020  
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**KONTRATË**

**PËR**

**DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËNS KOMUNALE -  
DYQANIN**

**Palët kontraktuese**

- 1. Komuna e Gjakovës**, të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetar i Komunës, dhënësi i pronës komunale – dyqanin në rrugën “Mbretresha Teuta” me numër te njësisë kadastrale 1003-0-23-2-1-0 me sipërfaqe prej 53m<sup>2</sup>, (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe
- 2. Taulant Ndou B.I**, të cilën e përfaqëson Taulant Ndou, me numër personal me numër të biznesit nga Gjakova, shfrytëzues i pronës komunale - dyqanin me numër të njësisë kadastrale 1003-0-23-2-1-0 me sipërfaqe prej 53m<sup>2</sup> (në vazhdim të tekstit: Shfrytëzuesi).

**Neni 1  
Baza Juridike**

Baza juridike për lidhjen e kësaj kontrate është e përcaktuar në dispozitat e nenit 5, 6, 8 dhe 14 pika 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 60 të Ligjit Nr.05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit 01.Nr.011/11-21952, datës 03.06.2020, për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale-dyqanin, Njoftimit Publik 01Nr.463/01-10923 i datës: 28.05.2020, për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, Rekomandimit të Komisionit Vlerësues të datës: 01.07.2020.

## **Neni 2**

### **Objekti i Kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim afatshkurtër nga Komuna dhe marrja në shfrytëzim afatshkurtër nga Shfrytëzuesi, pronën komunale – dyqanin në rrugën “Mbreteresha Teuta” me sipërfaqe prej 53m<sup>2</sup>, me numër të njësisë kadastrale 1003-0-23-2-1-0 zona kadastral Gjakovë-Qytet.

## **Neni 3**

### **Kohëzgjatja e Shfrytëzimit**

1. Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që prona komunale - dyqani sipas në nenin 2 të kësaj kontrate të merret në shfrytëzim në kohëzgjatje prej 5 viteve, duke filluar nga data **15.07.2020 deri më datën 15.07.2025**.
2. Afati i shfrytëzimit nuk mund të zgjatet pa procedurë të re të njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.

## **Neni 4**

### **Vlera e Kompensimit për Shfrytëzimin**

Palët janë pajtuar që për shfrytëzimin e pronës komunale – dyqanin, që vlera e kompensimit për periudhën e cekur në nenin 3 të kësaj kontrate, për m<sup>2</sup> është **6.80€**, ndërsa për shumën e përgjithshme do të jetë: 360.40€ në muaj. **(treqindë e gjashtëdhjetë euro e katërdhjetë cent)**.

## **Neni 5**

### **Mënyra dhe Afatet e Pagesës së Kompensimit**

1. Palë janë pajtuar që pagesa e shumës së kompensimit nga shfrytëzuesi, për shfrytëzimin e pronës komunale – dyqanin e përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj kontrate të bëhet në fillim të çdo muaji, por jo ma larg se deri më datën 05 të muajit në vijim.
2. Shfrytëzuesi i pagesës së qirasë e bënë në ditë pune në xhirollogari të Komunës së Gjakovës me destinim: pagesa e kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale – dyqanin.

## **Neni 6**

### **Dorëzimi i Pronës Komunale - Dyqani në Shfrytëzim**

Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që dorëzim-pranimi i pronës komunale - dyqanit të bëhet më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga Komisioni i përcaktuar nga Komuna për lokalit afarist në prani të Shfrytëzuesi, me procesverbal. Komisionit do të emërohet me vendim të veçantë.

## **Neni 7 Destimi i Shfrytëzimit**

Prona komunale – dyqani sipas në nenin 2 të kësaj kontrate, nuk mund t’ia jep pronën komunale – dyqanin në shfrytëzim me nën-qira personave tjerë fizik dhe juridik, dhe nuk mund të jetë objekt i pengut (hipotekës) apo çfarëdo barre tjetër në raport me personat e tretë.

## **Neni 8 Obligimet e Komunës**

1. Komuna në pajtim me këtë kontratë është i obliguar që të i mundësoj pa pengesa, Shfrytëzuesit shfrytëzimin e pronës komunale - dyqanin.
2. Komuna obligohet që të evidentoi shënimet përkatëse në librat e pronësisë për shfrytëzimin e pronës komunale - dyqanin.

## **Neni 9 Obligimet e Shfrytëzuesit**

1. Qiramarrësi i pronës komunale - dyqanit në pajtim me këtë kontratë nuk i lejohet ushtrimi i këtyre veprimtarive: Tregtia dhe mirëmbajtja e mjeteve motorike, lustrimi, riparimet mekanike, riparimin e pjesëve të mjeteve motorike, spërkatjen dhe ngjyrosjen, riparimin e xhamave dhe dritareve, riparimin e ulëseve të mjeteve motorike, riparimin e rrotave dhe të gomave, montimin apo zëvendësimin, trajtimin kundër ndryshkut, si dhe veprimtarit tjera ekonomike të ndaluara me ligje përkatëse (lojëra të fatit), prodhimit bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to, veprimtarit e minierave dhe gurorëve (industria e nxjerrjes), tregtia me pakicë dhe shumice e produkteve ushqimore (pemëve dhe perimeve);
2. Shfrytëzuesi është i obliguar që t’i kryen të gjitha shërbimet e komunalive si ujë, rrymë mbeturinat etj, nga dita e marrjes në shfrytëzim.

## **Neni 10 Inspektimi**

Komuna ka të drejtën të kontrollojë dhe të inspektojë pronën komunale - dyqanin në çdo kohë, pa pasur kundërshtim nga shfrytëzuesi qiramarrësi. Inspektimi ka për qëllim për të konstatuar gjendjen momentale të pronës komunale - dyqanin gjatë kohës së shfrytëzimit nga ana e qiramarrësit.

**Neni 14**  
**Zbatimi i kontratës**

Për zbatimin në tërësi të kësaj kontrate do të kujdeset, Kryetari i Komunës duke e autorizuar Komisioni përgjegjës me vendim të veçante.

**Hyrja në Fuqi**

1. Kjo kontratë është përpiluar në katër (4) ekzemplarë autentik dhe përbënë pesë (5) faqe e cila pas leximit nga kontraktuesit është nënshkruar pa vërejtje.
2. Me kopje të kësaj kontrate përveç Qiradhënësit dhe Qiramarrësit do të njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Punë Inspektuese dhe Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe Prone.
3. Kjo kontratë hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

**PALË T**

**Komuna e Gjakovës**

*Ardian Gjini*  
**Ardian Gjini**



**Taulant Ndou B.I**

**Taulant Ndou**